

URDHËR
Nr. 147, datë 9.3.2020

**PËR NDËRPRERJEN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA
NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” DHE SPITALIN
UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”**

(ndryshuar me urdhrin nr. 219, datë 1.4.2020)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020, të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit nr. 395, datë 8.3.2020, të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjike të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.*
 2. Përfundim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëjnë vetëm ndërhyrjet kirurgjike për patologjitë malinje, të cilat do zhvillohen sipas planifikimit.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**